Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.
3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

22. Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.
- (d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të kualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga data e lidhjes së Marrëveshjes Kuadër

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Loti 1: “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve për “Ndërhyrjen rigjeneruese në blloqet e banimit” Faza II, Rajoni 1&2, 3&4”.

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

Lista e Objekteve për paketen: **“Ndërhyrje rigjeneruese në blloqet e banimit qytetëse, Faza II”**

Rehabilitim Blloqesh Banimi, Rajoni 1 & 2 (Qarku: Shkoder, Lezhe, Kukes, Tirane, Durres dhe Diber) dhe Rajoni 3 & 4 (Qarku: Korçe, Elbasan, Berat, Vlore, Fier dhe Gjirokaster). Projekte për veshjen e fasadave me sisteme kapote që përfshin rigjenerimin e blloqeve të banimit duke krijuar modele të reja jetëse, duke sjellë risi dhe përfitime të prekshme të lidhura me funksionalitetin dhe eficiencën e energjisë, duke i transformuar ato në mjedise të gjalla, estetikisht të bukura, ku jetohet në normalitet dhe kushte të përshtatshme dhe ku vlera e pronës rritet me efekt të menjëhershëm.

1. Objektivi kryesor i Mbikqyrjes

1.1 Mbikqyrësi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjejë mbarevajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Mbikqyrjes

2.1 Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.

2.2 Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë të zhvilluesit, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.

Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë on-line në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton on-line brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen on-line çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit.

Raporti Mujor do të përmbajë lenden e mëposhtme:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
- Te përgjithshme
- Qëllimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndërtimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyrësi

- Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
- Stafi aktual
- Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
- Raportimi
- Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- Pershkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
- Organizimi i Sipermaresit
- Sipermaresi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri
- Koheqendrimi ne objekt
- Progresi Mujor
- Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
- Fotografi te proceseve te punimeve te kryera
- Fotografi te punimeve te maskuara per çdo punim te padukshem
- Grafiku i ecurise se punimeve
- Te aprovuara
- Te kryera
- Volumet Progressive te Punimeve Mujore
- Punimet e Aprovuara
- Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike
- Libreza e Masave
- Punimet e Kryera por te pa aprovuara
- Situacionet mujore
- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhera, Udhezime, Njoftime
- Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Kontraktor)
- Moti (kalendarik)
- Problemet qe kane dale
- Teknike
- Sociale
- Konkluzione

2.3 Mbikëqyrësi i punimeve miraton materialet e ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruar nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t'u përdorur në procesin e ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve kryen vëzhgimin dhe korrigjimin e detajeve të elementeve të parapërgatitura (parafabrikat), në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe standardet e cilësisë së materialeve, të cilat do të përdoren në procesin e ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve duhet të dokumentojë me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, argumentimin e shmangieve të palejuara, referuar standardeve shqiptare ose në mungesë të tyre standardeve evropiane.

2.4 Mbikëqyrësi i punimeve njofton zbatuesin e punimeve për porositë, urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në ditarin e objektit gjatë zbatimit të kontratës së punimeve dhe kolaudimit.

Mbikëqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të objektit i jep instruksione dhe urdhra me shkrim zbatuesit të punimeve sa herë që e shih të nevojshme, në zbatim të akteve ligjore e

nënligjore në fushën e ndërtimit dhe ky i fundit është i detyruar t'i respektojë ato, por duke pasur të drejtën t'i bëjë me shkrim zhvilluesit vërejtjet e tij për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve i kërkon zbatuesit të punimeve të zëvendësojë përfaqësuesit e tij dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur e gjykon dhe e vërteton se ata janë shkak për mossecurinë e punimeve në afat dhe me cilësi, sipas kushteve të kontratës. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim personit juridik të shoqërisë së zbatimit të punimeve, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.

- 2.5 Mbikëqyrësi i punimeve merr propozimet nga zbatuesi i punimeve për rritje të vlerës së kontratës apo zgjatje të afatit të punimeve dhe ia përcjell ato zhvilluesit për miratim.

Në rastin e punimeve shtesë, mbikëqyrësi kërkon nga zbatuesi i punimeve prova dhe inspektime shtesë për të verifikuar konformitetin e punimeve me projektin e specifikimit teknike, sipas kushteve të kontratës. Këto punime shtesë janë objekt i një raportimi të veçantë pranë autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit në sistemin on-line të lejeve të ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve njofton zhvilluesin për defektet e konstatuara gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për kohën e korigjimit të tyre.

- 2.6 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga zhvilluesi.

- 2.7 Mbikëqyrësi i punimeve, pasi njoftohet dhe merr propozimet nga drejtori i punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimit teknike, jep udhëzimet e tij për zgjidhjen e situatës me miratim të projektuesit.

- 2.8 Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave dhe të çdo prove tjetër inxhinierike të nevojshme të materialeve të vendosura në objekt, për të verifikuar cilësinë, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të zbatuesit të punimeve.

- 2.9 Mbikëqyrësi i punimeve kryen matjet në kantier në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve dhe për çdo shmangie të konstatuar mbi atë të lejuarën, të përcaktuar në aktet ligjore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, pezullon punimet dhe njofton menjëherë zhvilluesin, autoritetin e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në sistemin e-leje.

- 2.10 Mbikëqyrësi i punimeve, kur gjykon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Nëse nga verifikimet rezulton që punimet janë kryer në shkelje të kushteve teknike të zbatimit, të standardeve e specifikimeve teknike, të përcaktuara në projektin e miratuar, ai me miratimin e zhvilluesit urdhëron pezullim të punimeve, për aq kohë sa është i nevojshëm korigjimi i defekteve, si dhe prishjen e ribërjen e tyre me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, brenda periudhës së korigjimit të defekteve.

Në rast se konstatohet që punimet e prishura nuk përbënin shkelje të kushteve teknike të zbatimit, standardeve e specifikimeve teknike, të përcaktuara në projektin e miratuar, zbatuesi i punimeve ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve për ribërjen e tyre, e cila mbahet nga sigurimi i profesionit që ka bërë mbikëqyrësi.

- 2.11 Mbikëqyrësi pezullon përkohësisht punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e zhvilluesit, për aq kohë sa është i nevojshëm korigjimi i punimeve me defekt.

Kur vërehen shkelje të dispozitave ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit, zhvilluesi dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit/Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e procesit të punës në kantier, deri në përcaktimin e llojit të shkeljes nga IMT-ja dhe deri në përcaktimin dhe marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes.

- 2.12 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të punimeve dhe i raporton çdo 45 (dyzet e pesë) ditë zhvilluesit për realizimin e tij, Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit.

Nëse ai konstaton vonesa në zbatimin e punimeve, njofton zhvilluesin për vonesat në kryerjen e punimeve të shoqëruar me arsyen e këtyre vonesave, edhe në intervalin midis dy raportimeve periodike.

- 2.13 Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet nga zbatuesi i punimeve kur punimet që do të mbulohen, do të maskohen ose do të betonohen janë gati për t'u kontrolluar prej tij. Me marrjen e njoftimit nga zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe miraton çdo punim përpara se të mbulohet, maskohet ose betonohet.

Në rast se mbikëqyrësi nuk njoftohet në kohë dhe punimet për maskimin ose betonimin janë kryer, mbikëqyrësi mban një procesverbal në prezencë të drejtuesit të punimeve, dhe njofton zhvilluesin dhe IKMT-në. Punimet fillojnë pas përcaktimit nga IKMT-ja për ecurinë e procesit të ndërtimit.

- 2.14 Mbikëqyrësi i punimeve bashkëpunon me zbatuesin e punimeve për çmimet e punimeve të reja, që nuk përfshihen në kontratë dhe në kërkesëpropozimin për ndryshimin e saj.

- 2.15 Mbikëqyrësi i punimeve ndërpret punimet për arsye të ndikimit të kushteve klimatike në procesin e ndërtimit, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit, sipas kushteve dhe detyrimeve të palëve për ndërprerje të punimeve, të përcaktuara në kontratë.

- 2.6 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon faturat e blerjes së materialeve dhe të çdo shpenzimi tjetër, që është i lidhur me ndërtimin e objektit, situacionet e paraqitura nga zbatuesi i punimeve në fazat e ndryshme të punimeve, si dhe kontabilitetin.

- 2.17 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar dhe i raporton periodikisht, çdo muaj, zhvilluesit për gjendjen e tij.

Zhvilluesi, nëse ka vërejtje në përdorimin e fondit rezervë, njofton zbatuesin e punimeve dhe merr masat e nevojshme për përdorimin e këtij fondi, për të cilin duhet të dakordësohen të dyja palët. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga zhvilluesi për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve të dakordësuara.

- 2.18 Mbikëqyrësi i dorëzon zbatuesit të punimeve aktin e përfundimit të punimeve dhe rezervat që do të parashtrihen për punimet gjatë kolaudimit.

Mbikëqyrësi, me kërkesë të zbatuesit të punimeve, vërteton me procesverbal datën e përfundimit të punimeve, sipas projektit, ndryshimeve të mundshme dhe kushteve të kontratës. Ai njofton zhvilluesin për përfundimin e punimeve në objekt.

- 2.19 Mbikëqyrësi i punimeve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i punimeve, merr nga zbatuesi i punimeve deklaratën teknike për punimet e kryera, e cila nënshkruhet nga drejtuesit teknikë e ligjorë të zbatuesit të punimeve, si dhe përgjegjësi teknik i punimeve në kantier, bazuar në dokumentacionin teknik të grumbulluar dhe të përpunuar në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve.

2.20 Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me drejtuesin e punimeve në përfundim të punimeve përgatit dokumentacionin e nevojshëm për kolaudim dhe së bashku me relacionin përfundimtar ia vendos në dispozicion zhvilluesit.

2.21 Në përgatitjen për kolaudim mbikëqyrësi i punimeve kryen mbikëqyrjen përfundimtare, që konsiston në:

- përputhshmërinë e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. Kontrollin në objekt për të verifikuar, nëse ka defekte, të cilat janë brenda afatit të garancisë. Nëse konstaton defekte, kërkon nga zbatuesi i punimeve korrigjimin e tyre, duke përcaktuar një afat kohor, në përputhje me llojin e defektit, para skadimit të afatit të garancisë kontraktuale ose të paktën në dy vitet e para pas pranimit të përfundimeve të punimeve;
- mbledhjen e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatin përfundimtar të projektit të zbatuar;
- përgatitjen e raporteve për gjendjen e objektit në bazë të gjetjeve nga kontrolli për aftësinë funksionuese të pjesëve të objektit dhe të objektit në tërësi;
- hartimin e listës për pajisjet dhe inventarin;
- përgatitjen e udhëzimeve për mirëmbajtjen dhe kujdesin e objektit, për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit;
- mbikëqyrjen e punimeve të mirëmbajtjes për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit, por jo më shumë se 2 (dy) vjet;
- verifikimin e analizës së ndërtimit të objektit dhe funksionimit të tij, shpenzimeve dhe defekteve;
- llogaritjen e shpenzimeve për ritarifimin e pagesës së projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit;
- konfirmimin se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara.

Ne përfundim të punimeve Mbikqyresi sipas legjislacionit në fuqi dorezon pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin perkates për të cilin mban përgjegjësi të plote në plotesimin, saktësinë dhe vertetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

- Proçes-verbalin e dorezimit të sheshit të ndërtimit
- Proçes-verbalin për fillimin e punimeve
- Kontraten e Siper marrjes
- Kontraten e Mbikqyrjes
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik të zbatimit
- Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korrespondencën, skicat perkatese dhe miratimet e nevojshme
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nëse ka) zerat të rinj të punimeve, negociimin e tyre)
- Grafikun e punimeve
- Specifikimet teknike
- Azhornimin para fillimit të punimeve dhe piketimi
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologjiko-inxhinjierik për punime të paparashikuara
- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme
- Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi të shoqëruar me fotografi
- Ditarin e objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikqyresi
- Librezen e masave
- Shkresën e Mbikqyresit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve, shoqëruar me dokumentacionin perkates
- Proçes-verbalin e përdorimit të fondit rezerve të firmosur nga Siper marrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Preventivin e fondit rezerve të firmosur nga Siper marrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Situacionin e fondit rezerve të firmosur nga Siper marrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Çertifikatat e cilësive të materialeve

-
- Miratimin e materialeve te perdorura nga Mbikqyresi
 - Situacionet pjesore dhe situacioni perfundimtar
 - Regjistrin e kontabilitetit
 - Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
 - Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
 - Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi, se bashku me matjet faktike te objektit te ndertuar
 - Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion përgatitet e dorëzohet në 3 (tre) kopje.

Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit. Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë grupit të kolaudimit duhet të jenë origjinale.

Mbikqyresi i punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet grupit të kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të objektit dhe firmos. Pas përfundimit të kolaudimit, Mbikqyresi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i behet e ditur Sipermarresit dhe i jepet për të likuiduar Autoritetit Kontraktor.

2.22 Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i njoftohet zbatuesit të punimeve dhe ia dorëzon për likuidim zhvilluesit.

Për përcaktimin e vlerës përfundimtare të punimeve të kryera në objekt, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe përllogarit koston përfundimtare, duke përputhur vlerën e preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe bën sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes.

2.23 Mbikqyresi i punimeve monitoron masat e sigurisë në kantiere dhe harton raportin PSK (referuar përmbajtjes minimale të PSK) të monitoruar e miratuar nga specialistët e HSE (Health, Safety and Environment) të autoritetit kontraktor. “Referuar Vendimit Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).”

3. Rregullat, procedurat dhe mënyra e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve

3.1. Korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me zhvilluesin dhe zbatuesin e punimeve është pjesë e dokumentacionit të objektit.

Në dosjen e mbikëqyrjes së punimeve pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, si akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshëm të dhënë nga mbikëqyrësi i punimeve, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës si dhe zgjidhjet e tyre, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

3.2 Mbikëqyrësi i punimeve nëpërmjet drejtuesit të punimeve njihet me librin e kantiere, dokumentacionin e kontabilitetit teknik e të furnizimit të objektit me materiale e produkte ndërtimi, me fotografitë, kasetat filmike dhe çdo dokument tjetër, që provon saktësinë dhe cilësinë e produkteve dhe të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet për inspektim të punimeve që do të bëhen të maskuara nga zbatuesi i punimeve për marrjen e kampionëve për kryerjen e provave, të analizave të përcaktuara në rregullat teknike ose të kërkuara shpesh nga vetë ai.

3.3 Mbikëqyrësi i punimeve para fillimit të punimeve bën verifikimin paraprak, që konsiston në:

- a) verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, autorizimeve dhe lejeve;
- b) verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet;
- c) njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe të të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate;
- ç) marrjen në dorëzim të punës dhe të furnizimeve të materialeve nga zbatuesi i punimeve, duke mbajtur një procesverbal për rezultatin e marrjes në dorëzim;
- d) verifikimin, vendosjen e tabelës së identifikimit në kantier me të dhënat e mëposhtme:

- i. Emërtimi i objektit;
- ii. Data e marrjes së lejes së ndërtimit;
- iii. Zhvilluesi;
- iv. Projektuesi;
- v. Zbatuesi i punimeve dhe drejtuesi teknik;
- vi. Mbikëqyrësi;
- vii. Afati i ndërtimit;
- viii. Sipërfaqja e ndërtimit;
- ix. Lartësia (numri i kateve mbi dhe nën tokë).

3.4 Mbikëqyrësi i punimeve dhe zhvilluesi, për çdo objekt që ndërtohet, administrojnë në kantier dokumentacionin teknik dhe mbajnë përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e tij, si:

- a) lejen e zhvillimit, lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi kompetent, si dhe me planvendosjen;
- b) aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas shtojcës i bashkëlidhet këtij vendimi;
- c) projektin e zbatimit, të miratuar nga organi, i cili ka këtë të drejtë, sipas juridiksionit dhe oponencën teknike;
- ç) preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha volumet e punimeve, të hartuara nga projektuesit;
- d) studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;
- dh) studimin sizmik;
- e) planorganizimin e punimeve të ndërtimit, i cili përmban planin e ngritjes dhe organizimit të kantierit, grafikun e përgjithshëm të punimeve dhe planin e veprimit për ndërtimin e objektit sipas projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës;
- ë) aktin e miratimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, miratuar nga organi kompetent;
- f) ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre, si dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të gjitha problemet e verifikuara, të miratuara dhe të firmosura nga ai;
- g) certifikatën profesionale (licencat) të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit;
- gj) njoftimin për fillimin e punimeve, sipas shtojcës VI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- h) procesverbalin mbi fillimin e punimeve në objekt, sipas shtojcës X, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- i) aktin e piktimit të objektit, sipas shtojcës IX, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- j) aktkontrollin e kuotës + 0.00, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- k) aktet e miratimit në fushën e trashëgimisë kulturore, arkeologjike apo zonat e mbrojtura mjedisore, sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
- l) librezën e masave, ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e punimeve, sipas shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit;
- ll) situacionet mujore pjesore dhe progressive, të hartuara mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, sipas shtojcës XII, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

-
- m) librin e kantierit;
 - n) ditarin e objektit, sipas shtojcës V, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - nj) pasqyrën e realizimit të punimeve, sipas shtojcës XI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - o) procesverbalet e punimeve të maskuara, sipas shtojcave VII dhe VIII, që i bashkëlidhen këtij vendimi;
 - p) provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura në objekt;
 - q) aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit;
 - r) deklaratën teknike të zbatuesit të punimeve, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - rr) aktin e kolaudimit të fazës së karabinasë;
 - s) dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe paisjen me mjete mbrojtëse përkatëse;
 - sh) aktet e inspektimit të kryera gjatë zbatimit të punimeve, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
 - t) dokumentin e vlerësimit të rrezikut, që hartohet për një kantier të veçantë, sipas vendimit nr.312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, i quajtur Plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK);
 - th) siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt;
 - u) siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike;
 - v) policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale;
 - x) dokumentacionin fotografik apo videoregjistrimin për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, punimet e maskuara;
 - xh) projektin e zbatuar;
 - y) projektin për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;
 - z) certifikimi i montimit të ashensorëve dhe inspektimi final;
 - zh) raportimet 45 ditore të bëra pranë Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe autoritetit të lëshimit të lejes së ndërtimit.

3.5 Mbikëqyrësi i punimeve për proceset e ndërtimit të objekteve të banimit, social-kulturore dhe ekonomike mban aktet e kontrollit, sipas këtyre fazave:

- a) Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues;
- b) Piketimi i strukturës;
- c) Përfundimi i themeleve dhe kuota + 0.00;
- ç) Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin;
- d) Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik;
- dh) Përfundimi i sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese.

Aktet e kontrollit janë pjesë e dokumentacionit që mbahet në objekt dhe një kopje depozitohet pranë njësisë vendore, të shoqëruara me një deklaratë përgjegjësie, të plotësuar nga subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar, sipas fazave të grafikut të punimeve dhe afatit të lejes.

3.6 Mbikëqyrësi i punimeve, pas verifikimeve të përcaktuara në piken 2.2, të termave të referencës, harton këto dokumentacione:

- a) Aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit që ia dorën zbatuesit të punimeve;
- b) Aktin e dorëzimit nga zbatuesi i punimeve të dokumentacionit, teknik dhe administrativ, si licenca, autorizime e leje të marra për ndërtimin e objektit;
- c) Shkresën, me atë të së cilës njofton autoritetin vendor dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbikëqyrjes së Territorit/Inspektoratin Vendor të Mbikëqyrjes së Territorit për fillimin e punimeve.

3.7 Mbikëqyrësi i punimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim nga zbatuesi i punimeve për përfundimin e punimeve, nëse nuk i vihet në dispozicion, i kërkon zbatuesit të punimeve dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Kontratën dhe aktet që lidhen me të;
- b) Regjistrimin e kontabilitetit;
- c) Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve;
- ç) Certifikatat e cilësisë së provave të materialeve të përdorura gjatë procesit të ndërtimit, të lëshuara nga laboratorët e akredituar për këtë qëllim;
- d) Për materiale të importuara, certifikatën e cilësisë nga një laborator i akredituar nga vendet e Bashkimit Evropian;
- dh) Deklaratën që vërteton se objekti është zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit pa shmangie në drejtimet funksionale dhe statike, si dhe në përputhje me kushtet teknike në fuqi, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- e) Deklaratën që vërteton se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara, nëse ka pasur.

4. Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes

4.1 Sherbimi i mbikqyrjes zgjat për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve.

4.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikqyresit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të percaktuara
- Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuar, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike
- Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të urdherojë Mbikqyresin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave perkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbejnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislacionit në fuqi.

5. Mospermbushja e detyrimeve të Mbikqyresit të punimeve

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të penalizojë Mbikqyresit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij dhe në plotësimin e detyrave të percaktuara për shërbimin e mbikqyrjes.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e marrjes së masave konkrete/penalitetive kundërsht mbikqyresit të punimeve, në rastet e mospermbushjes së detyrimeve, të lidhura kryesisht me:

1. Konstatimin e mosprezencës në terren të inxhinierit resident të mbikqyrjes
Mbikqyresit i punimeve duhet të marrë të gjitha masat që në çdo kantier të jetë present një inxhinier resident.
2. Konstatimin e mungesës së cilësisë së zbatimit të punimeve.
Mbikqyresit duhet të sigurojë që cilësia e materialeve dhe produkti final i punimeve, është në përputhje me specifikimet teknike të kontratës, standartin dhe cilësinë. Të gjitha testimet duhet të kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe procedurave specifike dhe frekuencës së percaktuar në standart.
Mbikqyresit duhet të kryejë inspektime të rregullta për të parë cilësinë e punimeve dhe materialeve në përputhje me kontratën dhe praktikën më të mirë inxhinierike
3. Mungesën e raportimeve periodike të mbikqyresit, konstatimin e mangësive të çeshtjeve serioze të zbatimit në raportim, kjo sipas detyrimeve të percaktuara
Gjatë kohëzgjatjes dhe zbatimit të kontratës, Mbikqyresit i punimeve ka për detyrë të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor raport 1 (një) dhe 3 mujor të punimeve të kryera. Në këto raporte duhet të jepet një tablo e qartë e progresit të punimeve dhe të pagesave të kryera, realizimi i

punimeve ne vlere dhe %, afati kohor, realizimi i financimit. Struktura e raportimit duhet te jete ne perputhje me percaktimet dhe sipas permbajtjes ne keto Terma e Reference.

4. Mangesi te sherbimit te mbikqyrjes mbi mospermbushjen e detyrimeve kundrejt ceshtjeve te mbrojtjes se shendetit. Mos evidentimi i rasteve te sjelljeve jo konform rregullave dhe standartit ne kantier

Mbikqyresi duhet te monitoroje standartet sigurimit teknik gjate gjithë kohes pergjate zbatimit te projektit duke perfshire dhe sigurimin e publikut, vizitoreve dhe stafit te mbikqyresit. Mbikqyresi duhet te vleresoje propozimin e menaxhimit te trafikut dhe perputhjen me kerkesat e puneve ne kontrate.

5. Mos evidentimi nga ana e mbikqyresit te rasteve ku nuk jane permbushur detyrimet per ceshtjet sociale dhe ato te ndikimit ne mjedis ne kantierin e zbatimit te punimeve

Mbikqyresi duhet te aprovoje dhe te mbikqyrë ne menyre te vazhdueshme masat per mbrojtjen e mjedisit te identifikuara nga Kontraktori i punimeve, ne menyre qe te kryeje punimet ne menyre te sigurte, duke marre masat zbutese te nevojshme per te permbushur kerkesat lidhur me kontraten dhe autoritetet lokale;

Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e punimeve per nderprerjen e punes deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundervajtje administrative, autoriteti do te vendose sanksione/penalite ne baze te legjislacionit ne fuqi si dhe te vleresimit konkret te shkeljeve dhe parregullsive te hasura.

6. Detyrat e Mbikqyresit gjate periudhes se Garancise se Defekteve

- Inspektim te objektit gjate periudhe se garancise dhe hartimi i raportit 6 mujor (te pakten dy raporte brenda garancise)
- Mbikqyresi duhet te kontrolloje qe te gjitha ceshtjet qe lidhen me ESHS jane te realizuara konform kerkesave te zbatimit. Ne rast te ndonje mangesie, mbikqyresi duhet te leshoje instruksion per Zbatuesin qe te beje riparimet e duhura perpara leshimit te marrjes finale ne dorezim te objektit.
- Mbikqyresi duhet te kontrolloje realizimin e te gjitha verejtjeve/detyrave te lena me heret nga ana e tij per tu riparuar ne periudhen e defekteve.
- Te jape rekomandimet per funksionimin dhe mirembajtjen e objektit te perfunduar.
- Pas verifikimit te gjendjes se objektit dhe korigjimeve te defekteve, mbikqyresi leshon certifikaten e marjes perfundimtare ne dorezim te punimeve dhe pergatit raportin final te objektit te implementuar.

7 Staffi i angazhuar në Sherbimin e mbikqyrjes

Mbikqyresi i punimeve te zbatimit te objektit duhet **te kete të përfshirë në ekipin e tij gjate zbatimit te kontrates:**

- ✓ 1 Drejtues te Ekipit, i cili duhet te demonstroje qe ka eksperiencen e duhur ne sherbimin e mbikqyrjes duke qene i pajisur me License ne Sherbim Mbikqyrje.
 - Drejtuesi i ekipit te supervizionit te objektit eshte personi kyç dhe pergjegjes per organizimin dhe mbarevajtjen e kontrates. Duhet te pergatise raportin mujor dhe 3 mujor, eshte pika e kontaktit mes paleve, koordinon cdo veprimtari ne kontrollin e punimeve dhe njekohsisht eshte i autorizuar i operatorit per te vepruar ne emer te tij.
- ✓ 1 (nje) Arkitekt i cili do te jete pergjegjes per zbatimin e detajit te sistemit kapot perfshire dhe trajtimin e kornizave te dritareve, bojrat e perdorura sipas specifikimeve teknike te projektit, vendosjen e davancialeve ne dritare dhe trajtimin e piktures murale duke u pershtatur me eksterierin perreth.
- ✓ 1(nje) Inxhinier Ndërtimi

- Inxhinieri i Ndertimit eshte pergjegjjes per proceset specifike te ndertimit,perfshire punimet e betonit,hekurit,armaturave,refiniturave te jashtme dhe e brendeshme ne objekte si dhe cdo proces qe lidhet me anen ndertimore ne kontraten se zbatimit.
- ✓ 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
 - Inxhinieri Gjeodet eshte perfaqesuesi i mbikqyresit qe pergjigjet per mbarevajtjen e piketimeve dhe kontrollin e tyre ne raport me projektin e zbatimit, kontrollin e kuotave te jashtme dhe ato te brendeshme ne rastet e godinave, ne objektet e infrastruktures se jashtme eshte pergjegjjes per verifikimin e saktetise se profileve gjatesore,terthore dhe kuotave perkatese siaps projektit teknik te zbatimit si dhe pere punimet e maskuara ne bashkepunim me inxhinierin e kantierit(site).
- ✓ 1 (nje)Inxhinier Elektrik
 - Inxhinieri Elektrik dueht te beje kontrollin e punimeve specifike elektrike ne objekt,kontrollon perputhshmerine me projektin e zbatimit,jep udhezime apo miraton ndryshime ne lidhje me fushen qe mbulon, mbeshtet HSE per ceshtje te sigurise ne pune, ben miratimin e punimeve elektrike te kryera nga zbatuesi.
- ✓ 1(nje) Inxhinier Hidroteknik
 - Inxhinieri Hidroteknik duhet te kontrolloje dhe miratoje proceset e punimeve per instalimet hidrosanitare,te brendeshme,instalimet e rrjeteve te jashtem, te ujesjellesit,KUZ dhe te shkarkimeve.punimet qe kane te bejne me infrastrukturen e rrjeteve te ujesjellesave deh verpave te furnizimit me uje,impjanteve te trajtimit te ujerave dhe veprave hidroteknike.
- ✓ 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
 - Inxhinieri i mjedisit duhet te kontrolloje planin e pergatitur nga Kontraktori per ceshtjet mjedisore,kontrollon ecurine e punimeve ne perputhej me ligjin per Mjedisin. Kontrollon nivelet e ndotjeve (pluhur,akustike etj).
- ✓ 1 (nje) Inxhinier Mekanik eshte pergjegjjes per punime mekanike guardrel, fugat parmalet etj.
- ✓ 2 (dy) Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)
 - Inspektori per sigurine dhe shendetin ne pune do te jete ne pergjegjjes per miratimin e planit te propozuar nga zbatuesi per sigurine dhe shendetin ne pune.
- ✓ 1 (nje) Kontrollor i volumeve te punes (Quantity Surveyour)
 - Eksperti i volumeve te punes/sasive, duhet te beje kontrollin/matjen e cdo zeri pune te vendosur ne objekt. Eshte detyre e tij te beje certifikimin e te gjitha volumeve te objektit nepermjet miratimit te libesave te masave te cilat pergatiten nga kontraktori cdo dite dhe jane baza e situacioneve per pagese.
- ✓ 1 (nje) Kontrollor Cilesie
 - Eksperti i cilesise, miraton cdo material te paraqitur nga zbatuesi per tu vendosur ne objekt ne perputhe me standardet e kerkuara dhe specifikimet teknike te paracaktuara e projekt. Kerkon te gjitha certifikatat e cilesise,origjines,testimet e kryera nga fabrikat per materialet qe do vendosen e ne objekt. Nese materialet e propozuara kane mos perputhje me kerkesat ne projekt dhe specifikime teknike,eksperti nuk i pranon dhe urdheron zbatuesion te sjelle materiale te tjera qe plotesojne kerkesat e projektit. Eksperti i cilesise mund te kerkoje riberjen e testeve te materialeve qe do te vendosen ne objekt kjo ne perputhje me specifikimet teknike te projektit dhe me pike 3.2 te ToR.

8 Metodologjia e kerkuar per sherbimin e mbikqyrjes:

Operatori Ekonomik në metodologjine e propozuar duhet të tregojë menyren e realizimit të mbikqyrjes së punimeve për të gjithë ciklin e shtrirjes së aktivitetit të mbikqyrjes në kuadër të kontrates së nënshkruar, duke filluar me:

1. Mënyrën e organizimit te stafit per kryerjen e sherbimeve te mbikqyrjes se punimeve.
2. Planifikimin e aktiviteteve të mbikqyrjes
3. Pritshmerite (outputs) per secilin nga aktivitetet e percaktuara te mbikqyrjes
4. Planin e manaxhimit te risqeve,
5. Plani i manaxhimit te cilesise duke perfshire minimalisht aprovimin e karrierave,nyjeve te inerteve,furnitoreve te materialeve.
6. Aprovimet e materialeve dhe fillimin e punimeve
7. Kontrollin periodike te punimeve
8. Rekordet e inspektimeve te cilesise
9. Kontrollin per garantimin e implementimit te sasive dhe cilesise se produktit.
10. Shëndeti,siguria dhe ceshtjet mjedisore/sociale ne objekt

-
11. Kontrolle periodike per Sigurine dhe Shendetin, trajnime per stafin e punes
 12. Pergatitjen e dosjes HSE dhe implemtimin e saj ne projekt.
 13. Raportimet ditore, mujore, tre mujore dhe mënyra e strukturimit te tyre.
 14. Propozim për menyren e realizimit te mbikqyrjes se objekteve që do të implementohen paralelisht ne te njejten periudhe.
 15. Pergatitja e dosjes teknike/perfundimtare te objektit
 16. Planin e monitorimit te objektit gjate periudhes se garancise se defekteve si dhe monitorimin e kryerjes se ketyre riparimeve.
 17. Planin e menaxhimit te ndryshimeve ne projekt.

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet te propozoje Stafin inxhinerik Resident qe do te ndjeke punimet çdo dite ne terren, operatori ekonomik do duhet qe ne cdo kantier te kete nje Inxhinier Resident.

Loti 2: “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve për “Ndërhyrjen për përmirësimin e shtresave asfaltike”, Faza III, Rajoni 1&2, 3&4”.

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit te punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

Lista e Objekteve per paketen: “Ndërhyrje për përmirësimin e shtresave asfaltike Faza III Lot 1, Rajoni 1&2 dhe Lot 2 Rajoni 3&4”.

Ky projekt ka si qëllim të përmirësojë shtresat rrugore në varësi të kushteve fizike dhe teknike të rrugëve ekzistuese.

Keto nderhyrje do te implementohen ne disa prej akseve rrugore të cilat janë me problematikë për qarkullimin e automjeteve ne Rajonet 1 & 2 (Qarku: Shkoder, Lezhe, Kukes, Tirane, Durres dhe Diber) dhe Rajonet 3 & 4 (Qarku: Korce, Elbasan, Berat, Vlore, Fier dhe Gjirokaster).

1. Objektivi kryesor i Mbikqyresit

- 1.1 Mbikqyresi i punimeve te zbatimit te objektit ka per qellim te kontrolloje dhe te ndjeke mbarevajtjen e gjithe procesit te zbatimit te punimeve ne perputhje me projektin, kushtet teknike te zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor te percaktuar per kryerjen e punimeve dhe vleren e kontrates.

2. Detyrat dhe pergjegjesite e Mbikqyresit

- 2.1 Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.
- 2.2 Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.

Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë on-line në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton on-line brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen on-line çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit.

Raporti Mujor do te permbaje lenden e meposhtme:

- Hyrje

-
- Informacion i pergjithshem
 - Te pergjithshme
 - Qellimi i punimeve
 - Mbikqyrja e punimeve ndertimore
 - Personeli i siguruar nga Mbikqyresi
 - Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
 - Stafi aktual
 - Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
 - Raportimi
 - Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
 - Pershkrimi i Projektit
 - Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
 - Organizimi i Sipermaresit
 - Sipermaresi
 - Stafi prezent
 - Mjete dhe makineri
 - Koheqendrimi ne objekt
 - Progresi Mujor
 - Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
 - Fotografi te proceseve te punimeve te kryera
 - Fotografi te punimeve te maskuara per çdo punim te padukshem
 - Grafiku i ecurise se punimeve
 - Te aprovuara
 - Te kryera
 - Volumet Progressive te Punimeve Mujore
 - Punimet e Aprovuara
 - Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike
 - Libreza e Masave
 - Punimet e Kryera por te pa aprovuara
 - Situacionet mujore
 - Matjet topografike
 - Korrespondenca
 - Proces-Verbale
 - Urdhera, Udhezime, Njoftime
 - Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Kontraktor)
 - Moti (kalendarik)
 - Problemet qe kane dale
 - Teknike
 - Sociale
 - Konkluzione

2.3 Mbikëqyrësi i punimeve miraton materialet e ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruar nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t'u përdorur në procesin e ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve kryen vëzhgimin dhe korrigjimin e detajeve të elementeve të parapërgatitura (parafabrikat), në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe standardet e cilësisë së materialeve, të cilat do të përdoren në procesin e ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve duhet të dokumentojë me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, argumentimin e shmangieve të palejuara, referuar standardeve shqiptare ose në mungesë të tyre standardeve evropiane.

-
- 2.4 Mbikëqyrësi i punimeve njofton zbatuesin e punimeve për porositë, urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në ditarin e objektit gjatë zbatimit të kontratës së punimeve dhe kolaudimit.

Mbikëqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të objektit i jep instruksione dhe urdhra me shkrim zbatuesit të punimeve sa herë që e sheh të nevojshme, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fushën e ndërtimit dhe ky i fundit është i detyruar t'i respektojë ato, por duke pasur të drejtën t'i bëjë me shkrim zhvilluesit vërejtjet e tij për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve i kërkon zbatuesit të punimeve të zëvendësojë përfaqësuesit e tij dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur e gjykon dhe e vërteton se ata janë shkak për mosecurinë e punimeve në afat dhe me cilësi, sipas kushteve të kontratës. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim personit juridik të shoqërisë së zbatimit të punimeve, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.

- 2.5 Mbikëqyrësi i punimeve merr propozimet nga zbatuesi i punimeve për rritje të vlerës së kontratës apo zgjatje të afatit të punimeve dhe ia përcjell ato zhvilluesit për miratim.

Në rastin e punimeve shtesë, mbikëqyrësi kërkon nga zbatuesi i punimeve prova dhe inspektime shtesë për të verifikuar konformitetin e punimeve me projektin e specifikimit teknike, sipas kushteve të kontratës. Këto punime shtesë janë objekt i një raportimi të veçantë pranë autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit në sistemin on-line të lejeve të ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve njofton zhvilluesin për defektet e konstatuara gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për kohën e korigjimit të tyre.

- 2.6 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga zhvilluesi.

- 2.7 Mbikëqyrësi i punimeve, pasi njoftohet dhe merr propozimet nga drejtori i punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimit teknike, jep udhëzimet e tij për zgjidhjen e situatës me miratim të projektuesit.

- 2.8 Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave dhe të çdo prove tjetër inxhinierike të nevojshme të materialeve të vendosura në objekt, për të verifikuar cilësinë, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të zbatuesit të punimeve.

- 2.9 Mbikëqyrësi i punimeve kryen matjet në kantier në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve dhe për çdo shmangie të konstatuar mbi atë të lejuarën, të përcaktuar në aktet ligjore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, pezullon punimet dhe njofton menjëherë zhvilluesin, autoritetin e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në sistemin e-leje.

- 2.10 Mbikëqyrësi i punimeve, kur gjykon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Nëse nga verifikimet rezulton që punimet janë kryer në shkelje të kushteve teknike të zbatimit, të standardeve e specifikimeve teknike, të përcaktuara në projektin e miratuar, ai me miratimin e zhvilluesit urdhëron pezullim të punimeve, për atë kohë sa është i nevojshëm korigjimi i defekteve, si dhe prishjen e ribërjen e tyre me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, brenda periudhës së korigjimit të defekteve.

Në rast se konstatohet që punimet e prishura nuk përbënin shkelje të kushteve teknike të zbatimit, standardeve e specifikimeve teknike, të përcaktuara në projektin e miratuar, zbatuesi i punimeve ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve për ribërjen e tyre, e cila mbahet nga sigurimi i profesionit që ka bërë mbikëqyrësi.

-
- 2.11 Mbikëqyrësi pezullon përkohësisht punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e zhvilluesit, për aq kohë sa është i nevojshëm korrigjimi i punimeve me defekt.

Kur vërehen shkelje të dispozitave ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit, zhvilluesi dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit/Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e procesit të punës në kantier, deri në përcaktimin e llojit të shkeljes nga IMT-ja dhe deri në përcaktimin dhe marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes.

- 2.12 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të punimeve dhe i raporton çdo 45 (dyzet e pesë) ditë zhvilluesit për realizimin e tij, Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit.

Nëse ai konstaton vonesa në zbatimin e punimeve, njofton zhvilluesin për vonesat në kryerjen e punimeve të shoqëruar me arsyen e këtyre vonesave, edhe në intervalin midis dy raportimeve periodike.

- 2.13 Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet nga zbatuesi i punimeve kur punimet që do të mbulohen, do të maskohen ose do të betonohen janë gati për t'u kontrolluar prej tij. Me marrjen e njoftimit nga zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe miraton çdo punim përpara se të mbulohet, maskohet ose betonohet.

Në rast se mbikëqyrësi nuk njoftohet në kohë dhe punimet për maskimin ose betonimin janë kryer, mbikëqyrësi mban një procesverbal në prezencë të drejtuesit të punimeve, dhe njofton zhvilluesin dhe IKMT-në. Punimet fillojnë pas përcaktimit nga IKMT-ja për ecurinë e procesit të ndërtimit.

- 2.14 Mbikëqyrësi i punimeve bashkëpunon me zbatuesin e punimeve për çmimet e punimeve të reja, që nuk përfshihen në kontratë dhe në kërkesëpropozimin për ndryshimin e saj.

- 2.15 Mbikëqyrësi i punimeve ndërpret punimet për arsye të ndikimit të kushteve klimatike në procesin e ndërtimit, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit, sipas kushteve dhe detyrimeve të palëve për ndërprerje të punimeve, të përcaktuara në kontratë.

- 2.6 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon faturat e blerjes së materialeve dhe të çdo shpenzimi tjetër, që është i lidhur me ndërtimin e objektit, situacionet e paraqitura nga zbatuesi i punimeve në fazat e ndryshme të punimeve, si dhe kontabilitetin.

- 2.17 Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar dhe i raporton periodikisht, çdo muaj, zhvilluesit për gjendjen e tij.

Zhvilluesi, nëse ka vërejtje në përdorimin e fondit rezervë, njofton zbatuesin e punimeve dhe merr masat e nevojshme për përdorimin e këtij fondi, për të cilin duhet të dakordësohen të dyja palët. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga zhvilluesi për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve të dakordësuara.

- 2.18 Mbikëqyrësi i dorëzon zbatuesit të punimeve aktin e përfundimit të punimeve dhe rezervat që do të parashtrihen për punimet gjatë kolaudimit.

Mbikëqyrësi, me kërkesë të zbatuesit të punimeve, vërteton me procesverbal datën e përfundimit të punimeve, sipas projektit, ndryshimeve të mundshme dhe kushteve të kontratës. Ai njofton zhvilluesin për përfundimin e punimeve në objekt.

- 2.19 Mbikëqyrësi i punimeve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i punimeve, merr nga zbatuesi i punimeve deklaratën teknike për punimet e kryera, e cila nënshkruhet nga drejtuesit teknikë e ligjorë të zbatuesit të punimeve, si dhe përgjegjësi teknik i punimeve në

kantier, bazuar në dokumentacionin teknik të grumbulluar dhe të përpunuar në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve.

- 2.20 Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me drejtuesin e punimeve në përfundim të punimeve përgatit dokumentacionin e nevojshëm për kolaudim dhe së bashku me relacionin përfundimtar ia vendos në dispozicion zhvilluesit.
- 2.21 Në përgatitjen për kolaudim mbikëqyrësi i punimeve kryen mbikëqyrjen përfundimtare, që konsiston në:
- përputhshmërinë e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. Kontrollin në objekt për të verifikuar, nëse ka defekte, të cilat janë brenda afatit të garancisë. Nëse konstaton defekte, kërkon nga zbatuesi i punimeve korrigjimin e tyre, duke përcaktuar një afat kohor, në përputhje me llojin e defektit, para skadimit të afatit të garancisë kontraktuale ose të paktën në dy vitet e para pas pranimit të përfundimeve të punimeve;
 - mbledhjen e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatin përfundimtar të projektit të zbatuar;
 - përgatitjen e raporteve për gjendjen e objektit në bazë të gjetjeve nga kontrolli për aftësinë funksionuese të pjesëve të objektit dhe të objektit në tërësi;
 - hartimin e listës për pajisjet dhe inventarin;
 - përgatitjen e udhëzimeve për mirëmbajtjen dhe kujdesin e objektit, për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit;
 - mbikëqyrjen e punimeve të mirëmbajtjes për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit, por jo më shumë se 2 (dy) vjet;
 - verifikimin e analizës së ndërtimit të objektit dhe funksionimit të tij, shpenzimeve dhe defekteve;
 - llogaritjen e shpenzimeve për ritarifimin e pagesës së projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit;
 - konfirmimin se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara.

Ne përfundim të punimeve Mbikëqyrësi sipas legjislacionit në fuqi dorezon pranë Autoritetit Kontraktor të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plote në plotësimin, saktësinë dhe vërtetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë:

- Proçes-verbalin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit
- Proçes-verbalin për fillimin e punimeve
- Kontraten e Siper marrjes
- Kontraten e Mbikëqyrjes
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik të zbatimit
- Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korrespondencën, skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme
- Preventivin fitues
- Preventivin e ndryshuar (nëse ka) zerat të rinj të punimeve, negociimin e tyre)
- Grafikun e punimeve
- Specifikimet teknike
- Azhornimin para fillimit të punimeve dhe piketimi
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologjik-inxhinjierik për punime të paparashikuara
- Dokumentacionin fotografik apo video regjistruar për punimet e padukshme
- Proçes-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi
- Ditarin e objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikëqyrësi
- Librezen e masave
- Shkresën e Mbikëqyrësit për investitorin ku raporton përdorimin e fondit rezerve, shoqëruar me dokumentacionin përkatës
- Proçes-verbalin e përdorimit të fondit rezerve të firmosur nga Siper marrësi (drejtuesi teknik) dhe Mbikëqyrësi

- Preventivin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Situacionin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
- Çertifikatat e cilesise se materialeve
- Miratimin e materialeve te perdorura nga Mbikqyresi
- Situacionet pjesore dhe situacioni perfundimtar
- Regjistrin e kontabilitetit
- Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
- Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
- Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi, se bashku me matjet faktike te objektit te ndertuar
- Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit

I gjithë dokumentacioni duhet te kete miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion pergatitet e dorezohet ne 3 (tre) kopje.

Nje kopje e te gjithë dokumentacionit dorezohet prane grupit te kolaudimit qe ngrihet brenda 30 diteve nga perfundimi i objektit. Te gjithë dokumentat qe dorezohen prane grupit te kolaudimit duhet te jene origjinale.

Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne Kolaudimin e objektit dhe i pergjigjet grupit te kolaudimit per te gjithë dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te objektit dhe firmos. Pas perfundimit te kolaudimit, Mbikqyresi i punimeve mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjetër, percakton vleren perfundimtare te objektit, e cila i behet e ditur Sipermarresit dhe i jepet per te likuiduar Autoritetit Kontraktor.

2.22 Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i njoftohet zbatuesit të punimeve dhe ia dorëzon për likuidim zhvilluesit.

Për përcaktimin e vlerës përfundimtare të punimeve të kryera në objekt, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe përlllogarit koston përfundimtare, duke përputhur vlerën e preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe bën sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes.

2.23 Mbikqyresi i punimeve monitoron masat e sigurise ne kantier dhe harton raportin PSK (referuar përmbajtjes minimale të PSK) te monitoruar e miratuar nga specialistët e HSE (Health, Safety and Environment) të autoritetit kontraktor. “Referuar Vendimit Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).”

3. **Rregullat, procedurat dhe mënyra e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve**

3.1. Korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me zhvilluesin dhe zbatuesin e punimeve është pjesë e dokumentacionit të objektit.

Në dosjen e mbikëqyrjes së punimeve pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, si akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshëm të dhënë nga mbikëqyrësi i punimeve, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës si dhe zgjidhjet e tyre, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

3.2 Mbikëqyrësi i punimeve nëpërmjet drejtuesit të punimeve njihet me librin e kantierit, dokumentacionin e kontabilitetit teknik e të furnizimit të objektit me materiale e produkte ndërtimi, me fotografitë, kasetat filmike dhe çdo dokument tjetër, që provon saktësinë dhe cilësinë e produkteve dhe të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet për inspektim të punimeve që do të bëhen të maskuara nga zbatuesi i punimeve për marrjen e kampioneve për kryerjen e provave, të analizave të përcaktuara në rregullat teknike ose të kërkuara shtesë nga vetë ai.

3.3 Mbikëqyrësi i punimeve para fillimit të punimeve bën verifikimin paraprak, që konsiston në:

- a) verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, autorizimeve dhe lejeve;
- b) verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet;
- c) njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe të të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate;
- ç) marrjen në dorëzim të punës dhe të furnizimeve të materialeve nga zbatuesi i punimeve, duke mbajtur një procesverbal për rezultatin e marrjes në dorëzim;
- d) verifikimin, vendosjen e tabelës së identifikimit në kantier me të dhënat e mëposhtme:
 - i. Emërtimi i objektit;
 - ii. Data e marrjes së lejes së ndërtimit;
 - iii. Zhvilluesi;
 - iv. Projektuesi;
 - v. Zbatuesi i punimeve dhe drejtuesi teknik;
 - vi. Mbikëqyrësi;
 - vii. Afati i ndërtimit;
 - viii. Sipërfaqja e ndërtimit;
 - ix. Lartësia (numri i kateve mbi dhe nën tokë).

3.4 Mbikëqyrësi i punimeve dhe zhvilluesi, për çdo objekt që ndërtohet, administrojnë në kantier dokumentacionin teknik dhe mbajnë përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e tij, si:

- a) lejen e zhvillimit, lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi kompetent, si dhe me planvendosjen;
- b) aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas shtojcës i bashkëlidhet këtij vendimi;
- c) projektin e zbatimit, të miratuar nga organi, i cili ka këtë të drejtë, sipas juridiksionit dhe oponencën teknike;
- ç) preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha volumet e punimeve, të hartuara nga projektuesit;
- d) studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;
- dh) studimin sizmik;
- e) planorganizimin e punimeve të ndërtimit, i cili përmban planin e ngritjes dhe organizimit të kantierit, grafikun e përgjithshëm të punimeve dhe planin e veprimit për ndërtimin e objektit sipas projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës;
- ë) aktin e miratimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, miratuar nga organi kompetent;
- f) ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre, si dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të gjitha problemet e verifikuara, të miratuara dhe të firmosura nga ai;
- g) certifikatën profesionale (licencat) të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit;
- gj) njoftimin për fillimin e punimeve, sipas shtojcës VI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- h) procesverbalin mbi fillimin e punimeve në objekt, sipas shtojcës X, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- i) aktin e piketimit të objektit, sipas shtojcës IX, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- j) aktkontrollin e kuotës + 0.00, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- k) aktet e miratimit në fushën e trashëgimisë kulturore, arkeologjike apo zonat e mbrojtura mjedisore, sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
- l) librezën e masave, ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e punimeve, sipas shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit;
- ll) situacionet mujore pjesore dhe progressive, të hartuara mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit. Ato firmosen nga

drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, sipas shtojcës XII, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

- m) librin e kantierit;
- n) ditarin e objektit, sipas shtojcës V, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- nj) pasqyrën e realizimit të punimeve, sipas shtojcës XI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- o) procesverbalet e punimeve të maskuara, sipas shtojcave VII dhe VIII, që i bashkëlidhen këtij vendimi;
- p) provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura në objekt;
- q) aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit;
- r) deklaratën teknike të zbatuesit të punimeve, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- rr) aktin e kolaudimit të fazës së karabinasë;
- s) dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe paisjen me mjete mbrojtëse përkatëse;
- sh) aktet e inspektimit të kryera gjatë zbatimit të punimeve, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- t) dokumentin e vlerësimit të rrezikut, që hartohet për një kantier të veçantë, sipas vendimit nr.312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, i quajtur Plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK);
- th) siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt;
- u) siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike;
- v) policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale;
- x) dokumentacionin fotografik apo videoregjistrimin për çastet më të rëndësishme të zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, punimet e maskuara;
- xh) projektin e zbatuar;
- y) projektin për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;
- z) certifikimi i montimit të ashensorëve dhe inspektimi final;
- zh) raportimet 45 ditore të bëra pranë Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe autoritetit të lëshimit të lejes së ndërtimit.

3.5 Mbikëqyrësi i punimeve për proceset e ndërtimit të objekteve të banimit, social-kulturore dhe ekonomike mban aktet e kontrollit, sipas këtyre fazave:

- a) Ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues;
- b) Piketimi i strukturës;
- c) Përfundimi i themeleve dhe kuota + 0.00;
- ç) Përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin;
- d) Përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik;
- dh) Përfundimi i sistemit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese.

Aktet e kontrollit janë pjesë e dokumentacionit që mbahet në objekt dhe një kopje depozitohet pranë njësisë vendore, të shoqëruara me një deklaratë përgjegjësie, të plotësuar nga subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar, sipas fazave të grafikut të punimeve dhe afatit të lejes.

3.6 Mbikëqyrësi i punimeve, pas verifikimeve të përcaktuara në piken 2.2, të termave të referencës, harton këto dokumentacione:

- a) Aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit që ia dorën zbatuesit të punimeve;
- b) Aktin e dorëzimit nga zbatuesi i punimeve të dokumentacionit, teknik dhe administrativ, si licenca, autorizime e leje të marra për ndërtimin e objektit;
- c) Shkresën, me atë të së cilës njofton autoritetin vendor dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbikëqyrjes së Territorit/Inspektoratit Vendor të Mbikëqyrjes së Territorit për fillimin e punimeve.

3.7 Mbikëqyrësi i punimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim nga zbatuesi i punimeve për përfundimin e punimeve, nëse nuk i vihet në dispozicion, i kërkon zbatuesit të punimeve dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Kontratën dhe aktet që lidhen me të;
- b) Regjistrimin e kontabilitetit;
- c) Procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve;
- ç) Certifikatat e cilësisë së provave të materialeve të përdorura gjatë procesit të ndërtimit, të lëshuara nga laboratorët e akredituar për këtë qëllim;
- d) Për materiale të importuara, certifikatën e cilësisë nga një laborator i akredituar nga vendet e Bashkimit Evropian;
- dh) Deklaratën që vërteton se objekti është zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit pa shmangie në drejtimet funksionale dhe statike, si dhe në përputhje me kushtet teknike në fuqi, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- e) Deklaratën që vërteton se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara, nëse ka pasur.

4. Kohëzgjatja e shërbimit të Mbikqyrjes

4.1 Shërbimi i mbikqyrjes zgjat për gjithë periudhën e zbatimit të punimeve.

4.2 Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë largimin e Mbikqyresit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të percaktuara
- Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara, tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike
- Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të urdherojë Mbikqyresin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbejnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione në bazë të legjislativës në fuqi.

5. Mospermbushja e detyrimeve të Mbikqyresit të punimeve

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të penalizojë Mbikqyresin kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij dhe në plotësimin e detyrave të percaktuara për shërbimin e mbikqyrjes.

Autoriteti Kontraktor rrevon të drejtën e marrjes së masave konkrete/penalitetive kundërsht mbikqyresit të punimeve, në rastet e mospermbushjes së detyrimeve, të lidhura kryesisht me:

Konstatimin e mosprezencës në terren të inxhinierit resident të mbikqyrjes

Mbikqyresin e punimeve duhet të marrë të gjitha masat që në çdo kantier të jetë present një inxhinier resident.

Konstatimin e mungesës së cilësisë së zbatimit të punimeve.

Mbikqyresin duhet të sigurojë që cilësia e materialeve dhe produkti final i punimeve, është në përputhje me specifikimet teknike të kontratës, standartin dhe cilësinë. Të gjitha testimet duhet të kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe procedurave specifike dhe frekuencës së percaktuar në standart.

Mbikqyresin duhet të kryejë inspektime të rregullta për të parë cilësinë e punimeve dhe materialeve në përputhje me kontratën dhe praktiken me të mirë inxhinierike

Mungesën e raportimeve periodike të mbikqyresit, konstatimin e mangësive të çeshtjeve serioze të zbatimit në raportim, kjo sipas detyrimeve të percaktuara

Gjatë kohëzgjatjes dhe zbatimit të kontratës, Mbikqyresin e punimeve ka për detyrë të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor raport 1 (një) dhe 3 mujor të punimeve të kryera. Në këto raporte duhet të jepet një tablo e qartë e progresit të punimeve dhe të pagesave të kryera, realizimi i punimeve në vlerë dhe %, afati kohor, realizimi i financimit. Struktura e raportimit duhet të jetë në përputhje me percaktimet dhe sipas përmbajtjes në këto Terma e Reference.

Mangesi te sherbimit te mbikqyrjes mbi mospermbushjen e detyrimeve kundrejt ceshtjeve te mbrojtjes se shendetit. Mos evidentimi i rasteve te sjelljeve jo konform rregullave dhe standartit ne kantier

Mbikqyresi duhet te monitoroje standartet sigurimit teknik gjate gjithë kohes pergjate zbatimit te projektit duke perfshire dhe sigurimin e publikut, vizitoreve dhe stafit te mbikqyresit. Mbikqyresi duhet te vleresoje propozimin e menaxhimit te trafikut dhe perputhjen me kerkesat e puneve ne kontrate.

Mos evidentimi nga ana e mbikqyresit te rasteve ku nuk jane permbushur detyrimet per ceshtjet sociale dhe ato te ndikimit ne mjedis ne kantierin e zbatimit te punimeve

Mbikqyresi duhet te aprovoje dhe te mbikqyrë ne menyre te vazhdueshme masat per mbrojtjen e mjedisit te identifikuar nga Kontraktori i punimeve, ne menyre qe te kryeje punimet ne menyre te sigurte, duke marre masat zbutese te nevojshme per te permbushur kerkesat lidhur me kontraten dhe autoritetet lokale;

Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e punimeve per nderprerjen e punes deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundervajtje administrative, autoriteti do te vendose sanksione/penalite ne baze te legjislacionit ne fuqi si dhe te vleresimit konkret te shkeljeve dhe parregullsive te hasura.

6. Detyrat e Mbikqyresit gjate periudhes se Garancise se Defekteve

- 9 Inspektim te objektit gjate periudhe se garancise dhe hartimi i raportit 6 mujor (te pakten dy raporte brenda garancise)
- 10 Mbikqyresi duhet te kontrolloje qe te gjitha ceshtjet qe lidhen me ESHS jane te realizuara konform kerkesave te zbatimit. Ne rast te ndonje mangesie, mbikqyresi duhet te leshoje instruksion per Zbatuesin qe te beje riparimet e duhura perpara leshimit te marrjes finale ne dorezim te objektit.
- 11 Mbikqyresi duhet te kontrolloje realizimin e te gjitha verejtjeve/detyrave te lena me heret nga ana e tij per tu riparuar ne periudhen e defekteve.
- 12 Te jape rekomandimet per funksionimin dhe mirembajtjen e objektit te perfunduar.
- 13 Pas verifikimit te gjendjes se objektit dhe korigjimeve te defekteve, mbikqyresi leshon certifikaten e marjes perfundimtare ne dorezim te punimeve dhe pergatit raportin final te objektit te implementuar.

7 Stafi i angazhuar në Sherbimin e mbikqyrjes

Mbikqyresi i punimeve te zbatimit te objektit duhet **te kete të përfshirë në ekipin e tij gjate zbatimit te kontrates:**

- ✓ 1 Drejtues te Ekipit, i cili duhet te demoistroje qe ka eksperiencen e duhur ne sherbimin e mbikqyrjes duke qene i pajisur me License ne Sherbim Mbikqyrje.
 - Drejtuesi i ekipit te supervizionit te objektit eshte personi kyç dhe pergjegjes per organizimin dhe mbarevajtjen e kontrates. Duhet te pergatise raportin mujor dhe 3 mujor, eshte pika e kontaktit mes paleve, koordinon cdo veprimtari ne kontrollin e punimeve dhe njekohsisht eshte i autorizuar i operatorit per te vepruar ne emer te tij.
- ✓ 1(nje) Inxhinier Ndërtimi
 - Inxhinieri i Ndërtimit eshte pergjegjes per proceset specifike te ndertimit, perfshire punimet e betonit, hekurit, armaturave, refiniturave te jashtme dhe e brendeshme ne objekte si dhe cdo proces qe lidhet me anen ndertimore ne kontraten se zbatimit.
- ✓ 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
 - Inxhinieri Gjeodet eshte perfaqesuesi i mbikqyresit qe pergjigjet per mbarevajtjen e piketimeve dhe kontrollin e tyre ne raport me projektin e zbatimit, kontrollin e kuotave te jashtme dhe ato te brendeshme ne rastet e godinave, ne objektet e infrastruktures se jashtme eshte pergjegjes per verifikimin e saktetise se profileve gjatesore, terthore dhe

kuotave perkatase siaps projektit teknik te zbatimit si dhe pere punimet e maskuara ne bashkepunim me inxhinierin e kantierit(site).

- ✓ 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
 - Inxhinieri Hidroteknik duhet te kontrolloje dhe miratoje proceset e punimeve per instalimet hidrosanitare,te brendeshme,instalimet e rrjeteve te jashtem, te ujesjellesit,KUZ dhe te shkarkimeve.punimet qe kane te bejne me infrastrukturen e rrjeteve te ujesjellesave deh verpave te furnizimit me uje,impjanteve te trajtimit te ujerave dhe veprave hidroteknike.
- ✓ 1 (nje) Inxhinier Mjedisi
 - Inxhinieri i mjedisit duhet te kontrolloje planin e pergatitur nga Kontraktori per ceshtjet mjedisore,kontrollon ecurine e punimeve ne perputhej me ligjin per Mjedisin. Kontrollon nivelet e ndotjeve (pluhur,akustike etj).
- ✓ 1 (nje) Inxhinier Gjeolog i cili eshte pergjegjes per studimin e bazamentit te rruges per vleresimin e struktures se tokes dhe te bazamentit ekzistues ne menyre qe te percaktohet sakte tipologjia e nderhyrjes
- ✓ 2 (dy) Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)
 - Inspektori per sigurine dhe shendetin ne pune do te jete ne pergjegjes per miratimin e planit te propozuar nga zbatuesi per sigurine dhe shendetin ne pune.
- ✓ 1 (nje) Kontrollor i volumeve te punes (Quantity Surveyour)
 - Eksperti i volumeve te punes/sasive, duhet te beje kontrollin/matjen e cdo zeri pune te vendosur ne objekt. Eshte detyre e tij te beje certifikimin e te gjitha volumeve te objektit nepermjet miratimit te libesave te masave te cilat pergatiten nga kontraktori çdo dite dhe jane baza e situacioneve per pagese.
- ✓ 1 (nje) Kontrollor Cilesie
 - Eksperti i cilesise, miraton cdo material te paraqitur nga zbatuesi per tu vendosur ne objekt ne perputhe me standardet e kerkuara dhe specifikimet teknike te paracaktuara e projekt. Kerkon te gjitha certifikatat e cilesise,origjines,testimet e kryera nga fabrikat per materialet qe do vendosen e ne objekt. Nese materialet e propozuara kane mos perputhje me kerkesat ne projekt dhe specifikime teknike,eksperti nuk i pranon dhe urdheron zbatuesion te sjelle materiale te tjera qe plotesojne kerkesat e projektit. Eksperti i cilesise mund te kerkoje riberjen e testeve te materialeve qe do te vendosen ne objekt kjo ne perputhje me specifikimet teknike te projektit dhe me pike 3.2 te ToR.

8 Metodologjia e kerkuar per sherbimin e mbikqyrjes:

Operatori Ekonomik në metodologjine e propozuar duhet të tregojë menyren e realizimit të mbikqyrjes së punimeve për të gjithë ciklin e shtrirjes së aktivitetit të mbikqyrjes në kuadër të kontrates së nënshkruar, duke filluar me:

18. Mënyrën e organizimit te stafit per kryerjen e sherbimeve te mbikqyrjes se punimeve.
19. Planifikimin e aktiviteve te mbikqyrjes
20. Pritshmerite (outputs) per secilin nga aktivitetet e percaktuara te mbikqyrjes
21. Planin e manaxhimit te risqeve,
22. Plani i manaxhimit te cilesise duke perfshire minimalisht aprovimin e karrierave,nyjeve te inerteve,furnitoreve te materialeve.
23. Aprovimet e materialeve dhe fillimin e punimeve
24. Kontrolltet periodike te punimeve
25. Rekordet e inspektimeve te cilesise
26. Kontrolli per garantimin e implementimit te sasive dhe cilesise se produktit.
27. Shëndeti,siguria dhe ceshtjet mjedisore/socialte ne objekt
28. Kontrolle periodike per Sigurine dhe Shendetin, trajnime per stafin e punes
29. Pergatitjen e dosjes HSE dhe implemtimin e saj ne projekt.
30. Raportimet ditore, mujore,tre mujore dhe mënyra e strukturimit te tyre.
31. Propozim për menyren e realizimit te mbikqyrjes se objekteve që do të implementohen paralelisht ne te njejten periudhe.
32. Pergatitja e dosjes teknike/perfundimtare te objektit
33. Planin e monitorimit te objektit gjate periudhes se garancise se defekteve si dhe monitorimin e kryerjes se ketyre riparimeve.
34. Planin e menaxhimit te ndryshimeve ne projekt.

Gjithashtu Operatori Ekonomik duhet te propozoje Stafin inxhinerik Resident qe do te ndjeke punimet çdo dite ne terren, operatori ekonomik do duhet qe ne cdo kantier te kete nje Inxhinier Resident.

Loti 3: “Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve për “Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore”, si dhe “Ndërhyrje në ndërtimin e urave dhe nyjeve lidhëse Faza II”

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës së garancisë kur kërkohet nga investitori.

Lista e Objekteve per paketen:

- “Ndërhyrje në infrastrukturë rrugore, Faza II”
- “Nderhyrje per rikonstruksionin dhe ndërtimin e urave, Faza II”

Keto nderhyrje do te implementohen ne disa prej akseve rrugore të cilat janë me problematikë për qarkullimin e automjeteve. Pas verifikimeve ne terren do te nderhyhet per rruge te cilat paraqesin demtime te shtresave rrugore dhe ndertimin e urave per lidhjen e akseve rrugore apo rindertimin e urave qe perbejne rrezik per shfrytezimin e tyre. Keto nderhyrje parashikohen ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

1. Objektivi kryesor i Mbikqyresit

1.1 Mbikqyresi i punimeve te zbatimit te objektit ka per qellim te kontrolloje dhe te ndjeke mbarevajtjen e gjithe procesit te zbatimit te punimeve ne perputhje me projektin, kushtet teknike te zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor te percaktuar per kryerjen e punimeve dhe vleren e kontrates.

2. Detyrat dhe pergjegjesite e Mbikqyresit

2.1 Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.

2.2 Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.

Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë on-line në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton on-line brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen on-line çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit.

Raporti Mujor do te permbaje lenden e meposhtme:

- Hyrje
- Informacion i pergjithshem
- Te pergjithshme
- Qellimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndertimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyresi
- Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
- Stafi aktual

- Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
- Raportimi
- Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- Pershkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
- Organizimi i Sipermaresit
- Sipermaresi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri
- Koheqendrimi ne objekt
- Progresi Mujor
- Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
- Fotografi te proceseve te punimeve te kryera
- Fotografi te punimeve te maskuara per cdo punim te padukshem
- Grafiku i ecurise se punimeve
- Te aprovuara
- Te kryera
- Volumet Progressive te Punimeve Mujore
- Punimet e Aprovuara
- Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike
- Libreza e Masave
- Punimet e Kryera por te pa aprovuara
- Situacionet mujore
- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhera, Udhezime, Njoftime
- Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Kontraktor)
- Moti (kalendarik)
- Problemet qe kane dale
- Teknike
- Sociale
- Konkluzione

2.3 Mbikëqyrësi i punimeve miraton materialet e ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruar nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t'u përdorur në procesin e ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve kryen vëzhgimin dhe korrigjimin e detajeve të elementeve të parapërgatitura (parafabrikat), në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe standardet e cilësisë së materialeve, të cilat do të përdoren në procesin e ndërtimit.

Mbikëqyrësi i punimeve duhet të dokumentojë me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, argumentimin e shmangieve të palejuara, referuar standardeve shqiptare ose në mungesë të tyre standardeve evropiane.

2.4 Mbikëqyrësi i punimeve njofton zbatuesin e punimeve për porositë, urdhrat dhe udhëzimet e dhëna në ditarin e objektit gjatë zbatimit të kontratës së punimeve dhe kolaudimit.

Mbikëqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të objektit i jep instruksione dhe urdhra me shkrim zbatuesit të punimeve sa herë që e sheh të nevojshme, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fushën e ndërtimit dhe ky i fundit është i detyruar t'i respektojë ato, por duke

pasur të drejtën t'i bëjë me shkrim zhvilluesit vërejtjet e tij për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve i kërkon zbatuesit të punimeve të zëvendësojë përfaqësuesit e tij dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur e gjykon dhe e vërteton se ata janë shkak për mosqëndrueshmëri të punimeve në afat dhe me cilësi, sipas kushteve të kontratës. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim personit juridik të shoqërisë së zbatimit të punimeve, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.

- 2.5 Mbikëqyrësi i punimeve merr propozimet nga zbatuesi i punimeve për rritje të vlerës së kontratës apo zgjatje të afatit të punimeve dhe ia përcjell ato zhvilluesit për miratim.

